



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1481 Prot.

Lezhë, më 04.02.2022

VENDIM

Nr. 7 Datë 01.02.2022

PËR  
MIRATIMIN E PROJEKTIT “NDËRLIDHJA E TURIZMIT PËRMES  
TRASHËGIMISË KULTURORE DHE ZGJIDHJEVE INTELIGJENTE NË LEZHË  
DHE GJAKOVË”

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Thirrjes së tretë për aplikime nga Komisioni Evropian në “Programin ndërkufitar Shqipëri – Kosovë sipas Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II)”, aplikimit të projektit me reference aplikimi” IPA/2021/171146-2/8 “Ndërlidhja e turizmit përmes trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë” ku Bashkia Lezhë është aplikues kryesor ndërsa Komuna e Gjakovës dhe Creative Business Solutions(CBS) bashkëaplikantë, si dhe shkresës Nr. 21202 Prot., Datë 17.12.2021 nga Komisioni Evropian ku informojnë se Bashkia Lezhë është shpallur fituese me këtë projekt, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërlidhja e turizmit përmes trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë”.
2. Ngarkohet për të lidhur kontratën me donatorin dhe kontratat me partnerët në projekt si dhe zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
ERNEST RAKAJ